

**STATUTI  
I  
SHOQERISE**

**ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR  
"RUGOVE"SH.P.K**

**Date 01.02.2022**

## DEKLARIME PARAPRAKE:

Sot, me date 01.02.2022 (dymije e njezete dy), ne ortaket si me poshte:

**Z. Armand Duka**, shtetas shqiptar, i biri i Enver, i dtl. 07.10.1962, lindur ne Shijak e banues ne Durres, ne adrese Rr. "Petraq Boshnjaku" Nd.19, mbajtes i pasaportes Nr. SR8030813, me Nr.personal G21007108T;

**Z. Visar Kelmendi**, shtetas Kosovar, i biri i Ramiz, i dtl. 04.08.1960, banues ne Rr. "Mehmet Akif Ersoy" Nr.73, Prishtine, mbajtes i pasaportes te Shtetit te Kosoves Nr.P00448969, me Nr.personal 1010927095,

deklarojme miratimin e Statutit te shoqerine me pergjegjesi te kufizuar emertuar: "RUGOVE" sh.p.k.

### NENI 1

#### HYRJE, EMERTIMI, LOGO DHE VULA

1.1 Shoqeria me Pergjegjesi te Kufizuar "RUGOVE" sh.p.k eshte krijuar mbi bazen e iniciatives se lire se dy ortakeve.

1.2 Shoqeria me Pergjegjesi te Kufizuar "RUGOVE" sh.p.k eshte krijuar dhe e zhvillon veprimtarine e saj ne perputhje me te gjithë nenet e ketij statuti, ligjit Nr.9901, date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare" (i ndryshuar), te Republikes se Shqiperise dhe cdo akt tjetër ligjore ne fuqi;

1.3 Shoqeria me Pergjegjesi te Kufizuar "RUGOVE" sh.p.k, eshte person juridik shqiptar dhe si e tille do te filloje aktivitetin e saj tregtar, pas regjistrimit ne Qendren Kombetare te Biznesit, ne baze te ligjit Nr.9723, date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare e Biznesit" (i ndryshuar). Regjistrimi kryhet sipas neneve 26,28,32,35,42 te Ligjit.

1.4 Kjo shoqeri eshte krijuar si shoqeri me pergjegjesi te kufizuar dhe Ortaket e saj mbulojne humbjet deri ne kufirin e vleres se kapitalit themeltar.

1.5 Emertimi i shoqerise ne cdo akt qe do shkruhet eshte "RUGOVE" sh.p.k, me shkronja te medha.

### NENI 2

#### OBJEKTI I VEPRIMTARISE

2.1 Shoqeria ka si objekt te veprimtarise se saj:

- *Shitjen me shumice dhe pakice te ujit te pijshem te ambalazhuar. Tregtimin me shumice dhe pakice te pijeve te tjera apo te produkteve te ndryshme, te pijeve te ndryshme alkolike ose jo, lengjeve te frutave.*

- Blerje, shitje bime medicinale, blegtorale, bujqësore; industriale, elektroshtëpiake, te materialeve plastike duhanit dhe cigareve, automjeteve, makinerive e pjesëve të këmbimit për to dhe të lëndëve drusore, servis, furre buke.
- Tregtim te bulmetit (qumesht, kos, djath e gjithë nenproduktet e tyre); Tregtim te perimeve dhe frutave;
- Import-Eksport me shumicë dhe me pakicë të te gjitha produkteve sa me lart.
- Tregtim te automjeteve, mejeteve detare, makineri e pajisje, pjese kembimi per to, karburante, lenedeve djegese, lende drusore, mobilje, materiale ndertimi etj.
- Ne fushen e transportit: Transport tokesor, detar dhe ajror i mallrave dhe udhetareve;
- Import - eksport, tregti me shumice dhe pakice te mallrave apo te sherbimeve te prodhuara nga shoqeria, apo te mallrave, sherbimeve dhe produkteve te ndryshme;
- Bar-Kafe, Restorante, Hoteleri;
- Pjesemarrje ne proçedura prokurimi publik, tendera, ankande etj, si dhe proçedura te ngjajshme me to;
- Tregtim i transportit të mallrave/produkteve të ndryshme brenda vendit edhe për persona të tretë, me qira si dhe për llogari të tij.
- Transport mallrash/produkte ndërkombëtar, për persona të tretë me qira si dhe për llogari të tij

2.2 Shoqeria mund te kryeje te gjitha aktivitetet qe do te konsiderohen te nevojshme per permbushjen e objektit te saj; shoqeria mund te kete pjesemarrje ne shoqeri te tjera me objekt te ngjashem

2.3 Ne permbushjen e aktivitetit te veprimtarise, shoqeria mund te marre pjese ne ndermarrje apo shoqeri te tjera, qe nga momenti i themelimit te tyre ose me pas, duke perfshire shitblerjen e pjesemarrjeve ne keto shoqeri, si dhe mund te kryeje direkt apo indirekt te gjitha operacionet tregtare, financiare me karakter te luajtshem dhe te paluajtshem te cilat konsiderohen te nevojshme ose thjesht te dobishme dhe/ose te pershtatshme per permbushjen e aktivitetit te saj kryesor.

2.4 Shoqeria mund te hape dhe te mbaje llogari rrjedhese ne monedhe leke apo valuta te tjera prane bankave shqiptare apo te huaja, duke mundur gjithashtu te disponoje lirisht mjetet monetare te akumuluar ne to, ne perputhje me legjislacionin ne fuqi.

### NENI 3 KOHEZGJATJA

Kohezgjatja e aktivitetit te shoqerise do te jete per nje periudhe kohe te pacaktuar.

### NENI 4 SELIA E SHOQERISE

4.1 Selia qendrore e shoqerise eshte ne adresen: Koder Vore, Tirane, Pasuria me Nr 132/14/7, Zone Kadastrale 2183.




2 Asambleja e Pergjithshme ka kompetencen te hape vende te tjera te ushtrimit te aktivitetit, filiale dhe/ose dege dhe t'i mbylle ato, nese e vlereson te nevojshme per qellime te aktivitetin te saj.

4.3 Adresa zyrtare ekelektronike do te jete: muhamed.berisha@rugove.eu

## NENI 5

### SHTRIRJA TERRITORIALE

Shoqeria RUGOVE sh.p.k ushtron aktivitetin e saj ne te gjithe territorin e Republikes se Shqiperise.

## NENI 6

### KAPITALI DHE KUOTA

6.1 Kapitali themeltar i shoqerise eshte ne vleren prej 100 000(njeqindmije)leke. Kapitali mund te shlyhet me kontribute ne para dhe/ose kontribute ne natyre. Kapitali themeltar eshte i nenshkruar si me poshte, dhe eshte i ndare ne 2 (dy) kuota. Pjesmarrja e ortakeve ne kapitalin themeltar dhe kuota qe zoteron secili, jane si me poshte:

- **Z. Armand Duka**, eshte zoterues i 50% te kapitalit themeltar, e barabarte me 1 (nje) kuote, me vlere prej 50 000 (pesedhjetemije) leke,
- **Z. Visar Kelmendi**, eshte zoterues i 50% te kapitalit themeltar, e barabarte me 1 (nje) kuote, me vlere prej 50 000 (pesedhjetemije) leke;

6.2 Per vertetimin e pronesisë mbi kuotat e mesiperme shoqeria tregtare mund te leshoj ne emer te personit apo personave, qe zoterojne kuoten, nje certificate per te vertetuar zoterimin e kuotes se kapitali.

6.3 Kapitali i paguar perbehet nga teresia e kontributeve te shlyera dhe/ose qe do shlyhet nga Ortaku.

6.4 Kapitali themeltar i shoqërisë nuk eshte paguar nga ortaket e shoqerise ne miratimin e statutit dhe regjitrimit te kesaj shoqerie.

## NENI 7

### KOMUNIKIMI NE SHOQERI

7.1 Komunikimi (pervec sa eshte parashikuar ndryshe ne statut) ne shoqeri dhe midis ortakeve do te kryhet me poste elektronike dhe ky komunikim ka vlere te plote dhe zyrtare midis ortakeve dhe perpara cdo organi tjetër shtetëror/publik dhe privat.

7.2 Adresat e komunikimit me poste elektronike jane ato te percaktuar ne vijim ndersa adresa postare eshte ajo e percaktuar ne deklarimet paraprake te ketij Statuti deri ne ndryshimin e tyre me kerkese te cdo Ortaku. Ndryshimi i adreses postare dhe adreses se postes elektornike me kerkese te Ortakut behet duke njoftuar cdo Ortak me poste elektronike qe perfshin te gjithe Ortaket dhe detyrimisht Administratorin e shoqerise.

Adresat zyrtare te postes elektronike te ortakeve jane:

- **Z. Armand Duka**: Adrese e postes elektronike: [duka@aiba.al](mailto:duka@aiba.al)

## NENI 8

### E DREJTA E PARABLERJES, MENYRA E FITIMIT DHE KUOTAVE

- 8.1 Kuotat e kapitalit jane lirisht te transferueshme tek bashkeshortet, pasardhesve te tyre sipas vullnetit apo edhe ne rastin e ndarjes se pasurise ne bashkepronesi familjare, si dhe trashegimtareve ne rast vdekje. Ne keto raste nuk aplikohet e drejta e parablerjes per Ortaket e tjere.
- 8.2 Ortaku qe kerkon te transferoje kuoten e tij, tek te tretet, teresisht apo pjeserisht, eshte i detyruar qe fillimisht t'i rezervoje Ortakeve/ortakut tjetet te drejten e parablerjes. Per te lejuar ushtrimin e kesaj te drejte, Ortaku qe deshiron te transferoje kuoten e tij duhet te lajmeroj me shkrese zyrtare (*nepermjet sherbimit postar, rekomande lajmerim marrje*) ortakun apo te gjithë Ortaket qe figurojne te regjistruar ne Regjistrin e Qendres Kombetare te Regjistrimit (*ne adresen e secilit, qe rezultojne ne kete statut apo ne adrese ku konfirmohet marrja dijani*), duke e specifikuar cmimin e shitjes (ose vleren korrispondente nese kundervlera do te jete ne natyre), menyren e pageses dhe emrat e bleresve te mundeshem (*te tretet*). Gjithashtu, njoftimi te behet njekohesisht prej Ortakut edhe ne adresen elektronike te shoqerise, ku perfshihen per dijani ortaku tjetet apo te gjithë ortaket.
- 8.3 Pergjigjia e ofertes per te ushtruar te drejten e parablerjes duhet t'i kthehet ortakut ofertues, me shkrim (*nepermjet sherbimit postar, rekomande lajmerim marrje*), brenda 30 (tridhjete) diteve kalendarike, nga data qe ortaket kane marre njoftimin per oferten e shitjes. Nese ortaku/et e tjere nuk pergjigjen brenda afatit te mesiperm, prezumohet se ortaku/et kane hequr dore nga ushtrimi i se drejtes se parablerjes.
- 8.4 Ne rast se oferta e propozuar pranohet nga ortaku tjetet i shoqerise, ortaku propozues dhe ofertues kane te drejte dhe detyrim te perfundojne transaksionet perkatese te kalimit te kuotes brenda nje afati ditor 90 (nentedhjete) dite kalendarike, pervec se me marreveshje kane vendosur ndryshe.
- 8.5 Kalimi i kuotes tek te tretet pa respektuar proceduren e percaktuar ne kete nen eshte i pavlefshem per Ortakun shites dhe per cdo pale te trete qe blen kuoten e Ortakut shites.
- 8.6 Ortaku qe kalon kuoten dhe ai qe e fiton ate pergjigjen ne menyre solidare ndaj shoqerise per detyrimet qe rrjedhin nga zoterimi i kuotes, qe nga momenti i kalimit te kuotave. Regjistrimi i kalimit te kuotes ne QKB, ka afekt deklarativ.

## NENI 9

### ASAMBLEJA E PERGJITHSHME

- 9.1 Asambleja e Pergjithshme eshte organi me i larte vendimarrës i shoqerise, qe perfaqeson teresine e Ortakeve.

9.2 Vendimet e saj merren ne perputhje me legjislacionin ne fuqi dhe ketij Statuti dhe jane te detyrueshme per te gjithë ortaket. Ato protokollohen ne regjister te vecante ne perputhje me ligjin.

9.3 Asambleja ka te drejte te ushtroje ne cdo moment verifikime mbi Administratorin dhe te kontrolloje cdo dokument te shoqerise. Ajo mund te urdheroje apo te udhezoje Administratorin ne kryerjen e detyres se tij.

**Asambleja e Pergjithshme eshte pergjegjese per marrjen e vendimeve per shoqerine per ceshtjet:**

- a. Percaktimin e politikave tregtare te shoqerise;
- b. Ndryshimet e Statutit;
- c. Emerimin dhe shkarimin e Administratoreve;
- d. Emerimin shkakimin e likujduesve dhe te eksperteve kontabel te autorizuar;
- e. Percaktimin e shperblimeve per personat e permendur ne piken "c" dhe "d" te kesaj pike;
- f. Mbikqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret, perfshire pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe raporteve te ecurise se veprimtarise;
- g. Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe raporteve te ecurise se veprimtarise;
- h. Zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit;
- i. Pjestimin e kuotave dhe anullimin e tyre;
- j. Perfaqesimin shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve;
- k. Riorganizimin dhe prishjen e shoqerise;
- l. Miratimin e rregullave procedurale te mbledhjeve te asamblese;
- m. Ceshtje te tjera te parashikuara ne ligj, ne statut ose te cilat vete ortaket do e cmojne per ta diskutuar etj.

9.5 Asambleja e Pergjithshme thirret nga Administratori ose nga Ortaket e saj, apo nga cdo Ortak, nepermjet nje njoftimi zyrtar me shkrese, ose me njoftim nepermjet postes elektronike. Me kerkesen e nje Ortaku sa me siper, Administratori eshte i detyruar te therrase menjehere Mbledhjen e Asamblese se Pergjithshme sipas kerkeses ne daten e percaktuar nga Ortaku nese ka nje te tille. Nese Administratori nuk e therrret mbledhjen e Asamblese te thirrur nga Ortaku brenda 3 ditesh pune nga data e njoftimit te Ortakut, ky i fundit e therrret ate vete.

9.6 Njoftimi me shkrese apo elektronik duhet te permbaje vendin, daten, oren e mbledhjes dhe rendin e dites e tu dergohet te gjithë ortakeve, jo me vone se 7 (shtate) dite perpara dates se parashikuar per mbledhjen e asamblese. Megjithate jane te vlefshme edhe mbledhjet e Asamblese qe nuk jane thirrur si me siper, vetem nese te gjithë Ortaket e shoqerise jane prezent ne mbledhjen e Asamblese dhe jane dakord, per te marre vendime, pavaresisht parregullsise.

9.6.1 Rendi i dites percaktohet ne thirrjen e Mbledhjes se Pergjithshme dhe njoftohet nga Administratori dhe/ose Ortaku qe therrret Mbledhjen. Ortaket e tjere dhe /ose Administratori mund te bejne shtesa ne rendin e dites jo me vone se 48 ore para dates se njoftuar dhe/ose te rene dakort me mirekuptim per zhvillimin e Mbledhjes.

9.7 Asambleja e Pergjithshme mund te thirret ne cdo moment tjeter te parashikuar ne ligj, dhe sa here qe mbledhja eshte e nevojshme per te mbrojtur interesat e shoqerise.

8 Ne Mbledhjen e Asamblese se Pergjithshme mund te marrin pjese te gjithe ata qe figurojne te regjistruar ne librin e Ortakeve – ne Regjistrin tregtar prane QKB-se, ne daten e kryerjes se mbledhjes se Asamblese se Pergjithshme.

9.9 Ortaket mund te perfaqesohen vete, ose nepermjet nje personi te pajisur me prokure ose autorizim te thjeshte, jo Administrator, jo auditor ligjor, jo konsulent financiar apo kontabel i shoqerise, ose vartes i vete shoqerise apo ndonje shoqerie tjeter te kontrolluar prej saj. I takon Administratorit te verifikoje te drejten e pjesmarrjes per secilin Ortak.

9.10 Cdo ortak ka te drejte vote ne Asamble ne proporcion me vleren nominale te kuotes qe zoteron ne kapitalin e shoqerise.

9.11 Ortaku nuk mund te ushtroje te drejten e votes nese Asambleja e Pergjithshme, me shumice te kualifikuar, merr vendim per vleresimin e veprimtarise se tij, shuarjen e ndonje detyrimi ne ngarkim te tij, ngritjen e nje padie ndaj tij nga shoqeria, dhenien ose jote perfitimeve te reja.

9.12 Mbledhja e Asamblese drejtohet nga Administratori i shoqerise dhe ne mungese te tij pjesmarrjes me shumice te kapitalit ne mbledhje, zgjedhin nje drejtues te Mbledhjes.

9.13 Asambleja mund te emeroje nje sekretar jo ortak. Vendimet e asamblese duhet te nenshkruhen nga te gjithe ortaket prezent ne mbledhje, nga administratori si dhe nga sekretari, kur eshte thirrur nje i tille. Kur e parashikon te arsyeshme, Administratori i shoqerise proces verbalin e mbledhjes propozon te mbahet nga nje noter publik, te zgjedhur prej tij apo te rekomanduar nga Ortaket e shumices.

## NENI 10

### KUORUMI DHE MARRJA E VENDIMEVE

10.1 Asambleja e Pergjithshme mund te marre vendime me shumice te zakonshme per ceshtje te cilat jane rutine per aktivitetin tregtar te shoqerise sipas ligjit. Ne kete rast mund te merren vendime te vlefshme vetem nese marrin pjese ortaket me te drejte vote, qe zoterojne me shume se 30% te kuotave.

10.2 Asambleja e Pergjithshme, nder te tjera, merr vendime per ceshtje qe kane te bejne me:

- ndryshime te statutit te shoqerise;
  - te menyres dhe riorganizimit te aktivitetit tregtar te saj;
  - zmadhim apo zvogelim te kapitalit;
  - shperndarje te fitimeve te shoqerise;
  - prishje, mbyllje te aktivitetit, likuidimin e shoqerise;
  - shpalljen e falimentit te shoqerise;
  - emerim administratorit/ve;
  - kalimin/tjetersimin e kuotave te shoqerise;
  - miratimin e buxhet-it vjetor te shoqerise;
  - dhene te gjitha rastet per te cilat eshte e percaktuar shprehimisht ne ligj dhe/ose ne statut;
- 10.3 Per ceshtjet e percaktuara ne piken 10.2 vendimarrja eshte e vlefshme nese jane te pranishem ne mbledhje ortaket te cilet zoterojne me shume se gjysma e numrit total te votave dhe vendoset me shumice te kualifikuar ( $\frac{3}{4}$ ) te votave te ortakeve pjesemarrjes.

10.4 Ortaku nuk mund te perjashtohet nga e drejta e votes nese Asambleja e Pergjithshme merr vendim per:

- a. vleresimin e veprimtarise se tij;
- b. shuarjen e ndonje detyrimi ne ngarkim te tij;
- c. ngritjen e nje padie ndaj tij nga shoqeria;
- ç. Dhenien ose jo te perfitimeve te reja

10.5 Kur ortaku perfaqesohet nga nje perfaqesues i autorizuar, i autorizuari vleresohet te jete ne te njetin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku, te cilin perfaqeson.

## NENI 12

### ADMINISTRIMI DHE ADMINISTRATORI

11.1 Administrimi dhe perfaqesimi i shoqerise i besohet Administratorit, qe mund te mos jete ortak. Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve emerohet administratorin sipas pikes 10.2 paragrafi 7 dhe e shkarkon ate ne cdo kohe me shumice te zakonshme te votave. Administratori emerohet per nje periudhe 3 (tre) vjecare<sup>1</sup>, me te drejte ripertesitje, me perjashtim doreheqje, lirimi dhe shkarkimi nga funksioni prej Asamblese. Shperblimi i administratorit do te vendoset me vendim te asambese se ortakeve me shumice te zakonshme te votave.

11.2 Me vendim te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve, detyra e Administratorit te vetem i eshte besuar z. *Muhamed Berisha, i biri i Hanefi, i dtl.12.04.1988, lindur ne Prishtine Kosove dhe banues ne Tirane, Lagjia "Liqeni i thate", Rr. "Ullishtes", pall.13, Ap.26, Sauk Tirane, identifikuar me Pasaporten te Shtetit te Kosoves Nr.P01667361, me Nr.personal 1173980465, date leshimi 31.01.2020*, te cilit i jepet e drejta e firmes dhe perfaqesimit te shoqerise sipas percaktimeve ne statut dhe te ligjit Tregtar, si dhe kufizimeve ne baze te Statutit nese do te aplikohen.

11.3 Administratori gezon kompetenca te pakufizuara per realizimin e objektit te veprimtarise se shoqerise, me perjashtim te atyre kompetencave qe Statuti ose ne ligj ia njej Asamblese se Pergjithshme, apo kufizimeve qe mund te vendosen nga Ortaket.

11.4 Ne permbushje te detyres se tij, ai ka te drejte dhe detyrim te kryeje te gjitha veprimet e administrimit te veprimtarise tregtare te shoqerise, duke zbatuar politikat tregtare, te vendosura nga asambleja e pergjithshme; te perfaqesoj shoqerine tregtare ne marredhenie me te tretet; te kujdeset per mbajtjen e sakte e te rregullt te dokumentave dhe librave kontabel te shoqerise; te pregatis dhe te nenshkruaj bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise se veprimtarise dhe se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve, te paraqese keto dokumenta perpara asamblese se pergjithshme per miratim, te krijojte nje sistem paralajmerimi ne kohen e duhur per rrethanat, qe kercenojne mbarevajtjen e veprimtarise dhe ekzistencen e shoqerise; te kryeje regjistrimet dhe dergoje te dhenat e detyrueshme te shoqerise, sic parashikohet ne ligjin per Qendren Kombetare te Biznesit; te raportoje perpara asamblese se pergjithshme ne lidhje me

<sup>1</sup> Periudha 01.02.2022 deri me 01.02.2025.



Zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimi e veprimeve te posacme me rendesi te vecante per veprimtarine e shoqerise tregtare; te kryeje detyra te tjera te percaktuara ne ligj, ne statut dhe nga asamblea e pergjithshmesi dhe te vere ne levizje instance juridike dhe administrative, duke emeruar avokate e duke leshuar prokura apo autorizime ne raste te proceseve gjyqesore, duke kryer operacione bankare, ketu perfshire edhe hapjen e llogarive rrjedhese, nenshkrimin dhe xhirimin e ceqeve, realizimin e terheqjeve dhe derdhjeve me leke ne dore apo urdher xhirimi, tituj krediti, paradhenie krediti.

11.5 Administratori mund te emeruj perfaqesues, te cileve, individualisht apo bashkarisht, mund tu jape te drejten e firmes, si dhe ato kompetenca, shperblime e garanci qe do te vleresoj te arsyeshme. Ai mundet gjithashtu, te emeruje drejtues ose perfaqesues per akte apo kategori aktesh te caktuara.

## NENI 12

### PERGJEGJESITE E ADMINISTRATORIT

12.1 Administratori eshte pergjegjes individualisht, sipas rastit ndaj shoqerise ose te treteve, per shkeljet ligjore; parashikimeve statutore apo faje te kryera gjate administrimit te shoqerise.

12.2 Shoqeria nuk eshte pergjegjese ndaj te treteve, per aktivitete te kryera nga administratori ne kundershtim me kompetencat e tij, kur verteton se ata ishin ne dijeni te kesaj rrethane, edhe sipas parashikimeve statutore.

12.3 Administratori pergjigjet personalisht para shoqerise dhe/ose te treteve qe kane pesuar deme nga ndonje veprim i tij i paligjshem.

12.4 Administratori do te jete pergjegjes per cdo veprim tjetër, qe bie ne kundershtim me kompetencat e tij, te cilat penalizohen sipas legjislacionit perkates ne RSH-se.

## NENI 13

### AUDITORI LIGJOR I AUTORIZUAR

13.1 Emerimi i auditorit ligjor te autorizuar behet me Vendim te marre me shumice te thjeshte te Asamblese se Pergjithshme e cila percakton mandatin dhe shperblimin e tij.

13.2 Kur ligji e parashikon shprehimisht prezencen e auditorit ligjor te autorizuar, jane te pavlefshme operacionet e kryera ne kundershtim me percaktimet ligjore.

13.3 Auditori ligjor i autorizuar, pasi ka verifikuar librat kontabel, arken dhe depozitat bankare, garanton qe kontabiliteti vjetor eshte mbajtur ne rregull, i korespondon te vertetes dhe eshte ne perputhje me legjislacionin ne fuqi.


13.4 Auditori ligjor i autorizuar mund te shkarkohet nga funksionet e tij me vendim te asamblese se pergjithshme si dhe me vendim gjykate.

13.5 Auditori ligjor i autorizuar perpilon dhe i paraqet Asamblese nje raport financiar mbi ushtrimin vjetor qe pasqyron situaten finaciare ne nisje dhe ate ne mbyllje.

13.6 Kontrollon qe bilanci perfundimtar dhe Raporti i perpiluar nga Administratori per Asamblene, t'i korrespondoje realitetit.

13.7 Eshte i detyruar t'i paraqes Administratorit dhe Asamblese se Ortakeve:  
a. kontrollet, verifikimet dhe sondazhet e bera;

9



- a. Zerat e bilancit dhe dokumentacionin kontabel qe duhet korrigjuar duke sygjeruar edhe zgjidhjet;*  
*c. Gabimet dhe pasaktesite e konstatuara;*  
*d. Rezultatin financiar pas korrigjimeve te bera; si dhe kerkesa te tjera ligjore.*

13.8 Auditori ligjor i autorizuar duhet te thirret ne te gjitha mbledhjet e asamblese se ortakeve ku aprovohet bilanci i aktivitetit gjithe vjetor, por mund te thirret ne te gjitha rastet kur konsiderohet e nevojshme.

13.9 Auditori ligjor te autorizuar pergjigjet ndaj shoqerise dhe ndaj te treteve per pasojat negative qe rrjedhin nga gabime e neglizhence ne kryerjen e funksionit te tij. Nuk mban pergjegjesi per shkeljet ligjore te kryera nga Administratori, me perjashtim te rasteve kur ka pasur dijeni per to, por nuk i aka paraqitur dhe raportuar asamblese.

#### NENI 14

##### ZVOGLIMI DHE ZMADHIMI I KAPITALIT

14.1. Zvogelimi i kapitalit te shoqerise vendoset nga ortaket qe perfaqesojne te pakten  $\frac{3}{4}$  e votave te ortakeve pjesemarres ne Mbledhjen e Asamblese me kusht qe ne te te marrin pjese ortaket qe zoterojne me shume se gjysmen e numrit total te votave . Kur vendimi i zvogelimit te kapitalit nuk motivohet nga humbjet ne aktive, kreditorët e shoqerise duhen njoftuar menjehere, ata mund te kundershtojne vendimin prane organeve gjyqesore.

14.2 Zmadhimi i kapitalit themeltar, menyra e shlyerjes se tij permes kontributit ne para ose ne natyre, dhe afatet e kryerjes se tij, vendosen nga asambleja e ortakeve, qe perfaqesojne  $\frac{3}{4}$  e votave te ortakeve pjesemarres ne Mbledhjen e Asamblese me kusht qe ne te te marrin pjese ortaket qe zoterojne me shume se gjysmen e numrit total te votave. Pas vendimit te asamblese per zmadhimin e kapitalit, ortaket brenda afatit te caktuar duhet te bejne shlyerjet perkatese ne proporcion me kuoten e kapitalit qe zoteron secili. Ortaket qe kane votuar kundra zmadhimit te kapitalit nuk jane te detyruar te kontribuojne.

14.3 Rregullat procedurale per zmadhimin e kapitalit percaktohen ne Vendimin e Asamblese se Ortakeve, qe miraton kete zmadhim. Pas zmadhimit te kapitalit themeltar, Administratori duhet te regjistroje ne librin e ortakeve zmadhimin e kapitalit dhe vleren perkatese te kuotes qe do t'i takojne secilit ortak pas shlyerjes se tij.

#### NENI 15

##### SHPERNDARJA E FITIMEVE DHE KUFIZIMET

15.1 Ortaket kane te drejte te ndajne pjesen e fitimeve te tyre te deklaruar ne pasqyrat financiare te shoqerise.

15.2 Fitimi do t'i shperndahet ortakeve ne raport me kuotat e zoteruara ne shoqeri.


15.3 Shoqeria mund t'i shperndaj fitimet ortakeve, vetem nese pas pagimit te dividendit:

- a. Aktivët e shoqerise mbulojne teresisht detyrimet e saj;*
- b. Shoqeria ka aktive likuide te mjaftueshme per te shlyer detyrimet qe behen te kerkueshme brenda 12 muajve ne vazhdim.*

#### NENI 16

##### FITIMI DHE REZERVAT

10



16.1 Fitimi qe do te shperndahet perbehet nga fitimet e realizuara gjate vitit finaciar te sapo mbyllur. Asambleja mund te vendose per formimin dhe shperndarjen e fondeve te ndryshme.

16.2 Asambleja pasi ka miratuar bilancin perfundimtar dhe ka vendosur shumen qe do te shperndahet, percakton pjesen e fitimit per secilin ortak ne raport me kuoten qe zoteron secili. Shoqeria mund te shperndaje fitime ortakeve, vetem nese administratoret, nen pergjegjesine e tyre personale, leshojne nje certificate te aftesise paguse, e cila konfirmon shprehimisht se shperndarja e propozuar e dividendeve permbush kerkesat e nenit 77 te Ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare".

16.3 Gjate vitit, shoqeria ka te drejte ti jape ortakeve paradhenie mbi dividendet ne vlera jo me te medha se dividenti i shperndare nje vit me pare, me kusht qe:

a. *Te mbetet e depozituar nje reserve, e barabarte me paradheniet qe do te shperndahen;*  
b. *Nje ekspert kontabel i autorizuar te vertetoje ne nje relacion me shkrim qe fitimet neto te realizuara deri ne ate moment jane me te medha se paradheniet qe parashikohen per tu shperndare ortakeve.*

c. *Me Vendim Asambleje qe perfaqesojne  $\frac{3}{4}$  e votave te ortakeve pjesemarres ne Mbledhjen e Asamblese me kusht qe ne te marrin pjese ortaket qe zoterojne me shume se gjysmen e numrit total te votave, vendosin ndryshe sipas vleresimit te tyre.*

16.4 Shperndarja e paradhenieve vendoset nga Asambleja ne vendimin perkates duhet te specifikohen shumat dhe datat e kthimit.

16.5 Dividentet qe nuk korrespondojne me fitimet e realizuara realisht, mund tu reklamohen ortakeve qe i kane marre ato. Ortaket qe kane marre dividentin duhet ta kthejne ate ne shoqeri brenda nje periudhe jo me vone se 90 (nentedhjete) dite kalanderike nga kerkesa me shkrim e kryer nga Administratori dhe/ose Ortaket ne mungese te kerkeses nga Administratori.

#### NENI 17

#### PAVLEFSHMERIA,

17.1 Statuti si dhe akte te tjera te shoqerise konsiderohen te pavlefshem, vetem ne rast se shkelen dispozitat e parashikuara nga Ligji Nr.9901, date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare" i ndryshuar ose Kodi Civil.

17.2 Cdo akt tjeter i nxjerre prej organeve te shoqerise, ne kundersiztim me aq sa eshte parashikuar ne statut, konsiderohet i pavlefshem.

#### NENI 18

#### TRANSFORMIMI

18.1 Transformimi i shoqerise ne shoqeri aksionare, behet mbas hatimit te raportit te perkates nga Administratori dhe miratimin e Asamblese se Pergjithshme si eshte parashikuar ne nenin 10.3 me siper, ne perputhje me nenit 228 dhe 229 te Ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare".

18.2 Eshte e pavlefshme cdo transferimi i shoqerise ne kundersiztim me kete dispozite.

#### NENI 19

#### LARGIMI DHE PERJASHTIMI I ORTAKEVE

19.1 Ortaku mund të largohet nga shoqëria nëse ortakët e tjerë ose shoqëria kanë kryer veprime në dem të tij, nëse është penguar të ushtroje të drejtat e tij, nëse shoqëria i ka ngarkuar detyrime të paarsyeshme apo për shkak të tjerë, që bëjnë të pamundur vazhdimin e ortakërisë pasi të njoftojë me shkrim për arsyet e largimit.

19.2 Në bazë të një vendimi të marrë me shumicë të zakonshme në zbatim të nenit 9 pika 9.1 të Statutit, Asambleja e përgjithshme mund të kërkojë Gjykatës përjashtimin e ortakut, nëse ai nuk ka shlyer kontributin e tij, sipas parashikimeve të statutit ose nëse ekzistojnë shkaqe të tjerë të arsyeshme për këtë përjashtim. Në këto raste zbatohen parashikimet e nenëve 101, 102, 103 dhe 104 të Ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".

19.3 Shoqëria ka të drejtë të përjashtoj ortakun ose ortakët, në rast se ky i fundit nuk zbaton nenin 8 të statutit.

## NENI 20

### LIKUJDIMI I SHOQËRISË

20.1 Kur me Vendim të Gjykatës shpallet pavlefshmeria absolute apo relative e shoqërisë si dhe në rastet e parashikuara në ligj dhe në statut, Asambleja e Përgjithshme vendos prishjen e parakoheshme të shoqërisë dhe fillon procedurat e likuidimit që do të kryhen sipas kërkesave të parashikuara në Ligjin "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" dhe në përgjithësi nga legjislacioni shqiptar në fuqi.

20.2 Me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentare, prishja e shoqërisë ka sipasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, sipas nenëve 190 deri 204 të Ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".

## NENI 21

### PRISHJA E SHOQËRISË

21.1 Asambleja mund të vendosë prishjen e shoqërisë vetëm kur:

a. Me vendim të marrë me votën pro të ortakëve që përfaqësojnë  $\frac{3}{4}$  e votave të ortakëve pjesëmarrës në Mbledhjen e Asamblesë së Shoqërisë.

b. me hapjen e procedurave të falimentit;

c. nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të Ligjit "Për tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" dhe nenit 43 të Ligjit Nr.9723, datë 03.05.2007 "Për Qendren Kombëtare të Regjistrimit" i ndryshuar;

d. me Vendim të Gjykatës.

21.2 Secili ortak si pasojë e prishjes së shoqërisë, do të përfitoj pjesën e tij takuese të kapitalit në para ose kontributin në natyrë.

## NENI 22

### DISPOZITA TË FUNDIT

22.1 Shoqëria do të fillojë funksionimin e saj me miratimin e veprimtarisë së saj dhe regjistrimin në bazë të nenëve 26, 28, 32 e 35 të ligjit Nr. 9723 datë 03.05.2007 "Për Qendren Kombëtare të Regjistrimit" QKB, i ndryshuar, si dhe pranë cdo organi tjetër kompetentë të shtetit shqiptar, në bazë të legjislacionit në fuqi.

22.2 Për kryerjen e regjistrimeve perkatese, pranë cdo organi, i ngarkohet Administratorit të shoqërisë, apo cdo personi të tretë në bazë të një autorizimi.

22.3 Administratori ka te drejten te nenshkruaje per hapjen e pare te llogarise bankare te shoqerise dhe cdo veprim tjeter te nevojshem per fillimin e funksionimit normal te shoqerise.

22.3 Statuti hartohet ne 4 (kater) kopje origjinale me vlere te njejte ne gjuhen shqipe te cilat nenshkruhen ne cdo flete dhe ne fleten e fundit cilesohet emer, mbiemer, nenshkrimi.

22.4 Per aq sa nuk eshte parashikuar ne kete statut, dispozitat e ligjit ligjit Nr.9901, date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare" (i ndryshuar) do te kene zbatim, pervece se aplikimit te ndonje ligji tjeter te posacem, sipas rastit.

Statuti u lexua nga te gjitha Ortaket e shoqerise dhe nenshkruhet me vullnetin e lire te tyre si dhe deshires per te krijuar shoqerine.

**ORTAKET THEMELUES TE SHOQERISE  
"RUGOVE" sh.p.k**

**Z. Armand Duka**

*Armand Duka*

**Z. Visar Kelmendi**

*Visar Kelmendi*